



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA Komuna/Rahovec/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Drejtoria Komunale e Arsimit

IV- Nr. i prot. 226 Më 24.08.2018
Br. prot. 207 Odeljenje za Obrazovanje
RAHOVEC - ORAHOVAC Department of Education



Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032,të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2018/19 në këto shkolla.

1. SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec
Një edukator/e për parafillor klase me kohë të caktuar derisa të kthehet edukatorja nga pushimi i lehonisë
2. SHFMU "Mustafë Ibishi" në Kramovik
Një mësuesdhënëse/e me 10 orë për lëndën e biologjisë, me kohë të caktuar.
3. SHFMU "Sulejman Vokshi" në Polluzhë
Një mësues/e klase me kohë të caktuar.
4. SHFMU "Haki Stërmilli" - Zoqisht/ Paralelja e ndarë në Reti
Një mësuesdhënëse të gjuhës dhe letërsisë shqipe me 10 orë, me kohë të caktuar
5. SHMUM "Faik Sylka" në Rahovec
Një mësuesdhënëse/e në lëndën e violinës me 10 orë, për klasën e II-të, me kohë të caktuar.
Një mësuesdhënëse/e në lëndën e baletit me 10 orë, për klasën e parë, me kohë të caktuar.

Kushtet për konkurim:

Për vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas U.A.10/2018, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë. Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkangjitur dokumentet përkatëse në zyrat e DKA-së.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes. Dokumentet pranohen deri më datë 07.09.2018 në orën 16:00. Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më datën 10.09.2018, në objektin e SHMLP "Selajdin Mullaabazi-Mici" në Rahovec, duke filluar nga ora 10.00. Intervistimi me gojë i kandidatëve do të realizohet në datën 12 shtator, 2018, në DKA, duke filluar nga ora 10.00.

Rahovec, 24.08.2018



Avni Morina, Drejtor

Avni Morina